



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07
Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 20 maj 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Pestë mbi Ecurinë e Çështjes

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt
Tobi Kadman
Karl Bakli

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE¹ në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes.²

2. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim kornizë lidhur me nxjerrjen e provave, i cili përcakton, ndër të tjera, afatet për Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) që të përmbushë detyrimet për nxjerrjen e materialeve sipas Rregullores.³

3. Më 23 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim mbi mosnxjerrjen e dokumenteve sekuestruar Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 8, 17 dhe 22 shtator 2020 (përkatësisht “Paketa 1”, “Paketa 2” dhe “Paketa 3”; bashkërisht, “Tri Paketat”).⁴

4. Më 24 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes.⁵

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00089, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Seancës për Vetëdeklarim në lidhje me Fajësinë ose Pafajësinë dhe të Konferencës së Parë për Ecurinë e Çështjes dhe Çështje të lidhura me To*, 18 dhjetor 2020, publik, Transkripti, 8 janar 2021, publik.

³ KSC-BC-2020-07, F00104, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, 22 janar 2021, publik.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00141, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Nxjerrjen e Disa Dokumenteve Sekuestruar Organizatës së Veteranëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës*, 23 shkurt 2021, konfidencial.

⁵ KSC-BC-2020-07, F00129, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe Çështje lidhur me Të*, 17 shkurt 2021, publik, Transkripti, 24 shkurt 2021, publik.

5. Më 8 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një kalendar përmbledhës për pjesën e mbetur të procedurës paraprake, në të cilin ai përcaktoi, ndër të tjera, afatet për parashtrime të përbashkëta për çdo marrëveshje mbi aspekte ligjore dhe faktike, për parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me alibinë, arsyet që përjashtojnë përgjegjësi penale ose masat unike hetimore, për paraqitjen e Dosjes Paraprake të Mbrojtjes dhe për transmetimin e parashikuar të dosjes së çështjes (“Kalendari Përmbledhës”).⁶

6. Më 30 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e tretë mbi ecurinë e çështjes.⁷

7. Më 1 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi një kalendar të rishikuar për nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(3) dhe për çdo kërkesë nga ZPS-ja për mosnxjerrjen e këtyre materialeve (“Vendimi për Materialet e Rregullës 102(3)”).⁸

8. Më 14 prill 2021, në vijim të Vendimit për Materialet e Rregullës 102(3), ZPS-ja paraqiti një njoftim përmbledhës të hollësishëm të materialeve të rregullës 102(3) në zotërim (“Njoftimi Përmbledhës sipas Rregullës 102(3)”).⁹

9. Më 26 prill 2021, ZPS-ja paraqiti kërkesat për mosnxjerrjen, ndër të tjera, të disa materialeve të përfshira në Njoftimin Përmbledhës sipas Rregullës 102(3) (“Kërkesat e ZPS-së për Mosnxjerrje të Materialeve”).¹⁰

⁶ KSC-BC-2020-07, F00148, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Kalendari Përmbledhës për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake*, 8 mars 2021, publik, para. 6.

⁷ KSC-BC-2020-07, F00160, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes*, 23 mars 2021, publik, Transkripti, 30 mars 2021, publik.

⁸ KSC-BC-2020-07, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rëndësinë Materiale të Informacionit të Kërkuar sipas Rregullën 102(3) dhe Çështje në lidhje me Të*, 1 prill 2021, konfidencial.

⁹ KSC-BC-2020-07, F00183/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Njoftimit Përmbledhës të Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 14 prill 2021, konfidenciale.

¹⁰ KSC-BC-2020-07, F00190/RED, Prokurori i Specializuar, *Versioni i Redaktuar Konfidencial i Kërkesave dhe Kundërshtimeve të Prokurorisë në Pajtim me KSC-BC-2020-07/F00172*, 26 prill 2021, konfidencial.

10. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e katërt mbi ecurinë e çështjes.¹¹

11. Më 10 dhe 11 maj 2021, përkatësisht Mbrojtja e z. Gucati dhe Mbrojtja e z. Haradinaj, parashtruan përgjigjet e tyre ndaj Kërkesave të ZPS-së për Mosnxjerrjen e Materialeve.¹² Më 17 maj 2021, ZPS-ja parashtroi kundërpërgjigjen.¹³

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Në pajtim me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban konferenca për ecurinë e çështjes, nëse konsiderohet e nevojshme për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore dhe t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve palëve në lidhje me çështjen gjyqësore.

III. DISKUTIM

13. Në pajtim me rregullën 96(1) të Rregullores dhe për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencën e pestë mbi ecurinë e çështjes, të premtën më 28 maj 2021, në orën 11:00, për të rishikuar ecurinë e nxjerrjes së informacionit, për të marrë parashtrime nga Mbrojtja në lidhje me afatet e

¹¹ KSC-BC-2020-07, F00187, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Katërt mbi Ecurinë e Çështjes*, 18 dhjetor 2020, publik, Transkripti, 8 janar 2021, publik.

¹² KSC-BC-2020-07, F00199, Mbrojtja e z. Gucati, *Përgjigje ndaj Versionit të Redaktuar konfidencial të 'Kërkesave dhe Kundërshtimeve të Prokurorisë në Pajtim me KSC-BC-2020-07/F00172'*, KSC-BC-2020-07/F00190 të datës 26 prill 2020, 10 maj 2021, konfidencial; F00200, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Versionit të Redaktuar konfidencial të 'Kërkesave dhe Kundërshtimeve të Prokurorisë në Pajtim me KSC-BC-2020-07/F00172'*, dhe F00190, 11 maj 2021, konfidencial.

¹³ KSC-BC-2020-07, F00201, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigja e Prokurorisë ndaj Përgjigjeve të Mbrojtjes në lidhje me Parashtrimin F00190*, 17 maj 2021, konfidencial.

përcaktuara dhe hetimet në zhvillim si dhe për të trajtuar pika të tjera sikurse parashtrahet më poshtë.

14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë parashtrime në lidhje me pikat në vijim, sipas radhës së përcaktuar më poshtë:

(1) Kërkesat e ZPS-së për Mosnxjerrjen e Materialeve: Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkon parashtrime nga palët dhe Administratorja, siç është përcaktuar në Shtojcën konfidenciale të këtij urdhri;

(2) Nxjerrja e materialeve:

- a. nëse Mbrojtja mund të paraqesë, deri **të hënën më 14 qershor 2021**, kundërshtimet e saj, nëse ka, ndaj pranueshmërisë së provave të mbledhura që janë nxjerrë siç parashikohet në rregullën 95(2)(e) të Rregullores; dhe
- b. nëse palët po përballen ose parashikojnë të përballen me ndonjë vështirësi sa i takon pjesës së mbetur të procesit të nxjerrjes;

(3) Marrëveshja mbi aspekte ligjore dhe faktike:

- a. duke pasur parasysh se sipas Kalendarit Përmbledhës, afati i datës 9 prill 2021 ka kaluar, nëse palët mund të konfirmojnë se nuk do të arrihet asnjë marrëveshje mbi aspekte ligjore dhe faktike përpara transmetimit të parashikuar të dosjes gjyqësore; dhe
- b. nëse palët mund të konfirmojnë se nuk do të paraqitet një listë e pikave të kontestuara dhe një listë e pikave të pakontestuara para transmetimit të parashikuar të çështjes gjyqësore;

(4) Parashtrimet e Mbrojtjes dhe hetimet:

- a. duke pasur parasysh se sipas Kalendarit Përmbledhës, afati i datës 11 maj 2021 ka kaluar, nëse Mbrojtja mund të konfirmojë synimin e vet për të mos përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi

penale, që parashikohet në rregullën 95(5) të Rregullores dhe se nuk do të paraqitet asnjë masë hetimore unike, në pajtim me rregullën 99(1) të Rregullores;

- b. nëse Mbrojtja është në kohë për të plotësuar afatet e mbetura të përcaktuara në Kalendarin Përmbledhës; dhe
- c. nëse Mbrojtja është në gjendje që të japë një përditësim të ecurisë së hetimeve të veta, përfshirë sasinë e përgjithshme të përlllogaritur dhe llojin e dëshmive që synojnë t'i nxjerrin ZPS-së dhe nëse parashikohen kërkesa për masa mbrojtëse; dhe

(5) Objekti i paraburgimit: nëse ka pasur ndonjë zhvillim të mëtejshëm dhe përmirësim të metodave të përcjelljes së informacionit ndërmjet të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre.

15. Së fundi, palëve do t'u kërkohet që të bëjnë të ditura mendimet e tyre mbi nevojat për një konferencë shtesë të ecurisë së çështjes përpara transmetimit të dosjes gjyqësore, nëse përgjigja do të jetë pohuese, të propozojnë datë për konferencën e ecurisë së çështjes.

IV. VENDIM

16. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **VENDOS** që të mbahet një seancë në praninë e ZPS-së dhe Mbrojtjes, **të premtën më 28 maj 2021, në orën 11:00,**
- b. **URDHËRON** Zyrën Administrative që të paraqesë parashtrime me shkrim deri **të mërkurën më 26 maj 2021, në orën 16:00** për pikën (5) të paragrafit 14 dhe në një shtojcë konfidenciale të parashtrimit të lartpërmendur, parashtrime sipas paragrafit 5 të shtojcës; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen të paraqesin parashtrime me shkrim deri **të mërkurën më 26 maj 2021, në orën 16:00** mbi temat e përcaktuara

në pikat (2)-(4) të paragrafit 14 dhe në shtojcën konfidenciale të parashtrimit të lartpërmendur, sipas paragrafëve 3-4 të shtojcës.

/Nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 20 maj 2021
Në Hagë, Holandë.